



Burim për Prindërit:

Kujdesi ndaj Diabetit për Nxënësit në Shkollat Publike të DOE-së

Departamenti i Arsimit i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Department of Education – DOE) dhe Zyra e Shëndetit në Shkolla (Office of School Health – OSH) ofrojnë kujdes për nxënësit e DOE-së që kanë diabet.

Prindërit që kanë pyetje në lidhje me këtë përmbledhje mund të kontaktojnë Koordinatorin 504 të shkollës së fëmijës së tyre. Detajet për procesin e akomodimit 504 të DOE-së janë të shpjeguara në:

Akomodimet sipas Seksionit 504:

- Udhëzues për Nxënësin dhe Familjen: <https://www.schools.nyc.gov/docs/default-source/default-document-library/504-accommodations-student-and-family-guide>
- Rregullorja e Kancelarit A-710 (Chancellor's Regulation A-710): <https://www.schools.nyc.gov/docs/default-source/default-document-library/a-710>.

Marrëveshja Ligjore për Diabetin

Gjatë vitit shkollor 2022–2023, DOE zgjidhi një padi ligjore për të përmirësuar shërbimet e kujdesit ndaj diabetit për nxënësit me diabet të tipit 1 ose tipit 2 në shkollat publike të DOE-së. Vizitoni <https://www.schools.nyc.gov/school-life/health-and-wellness/staying-healthy/diabetes> për më shumë informacion rreth çështjes, M.F., et al. v. New York City Department of Education, et al., Civil No. 18-CV-6109. Marrëveshja pritet të zgjasë deri më 15 gusht 2027.

Ky informacion u drejtohet të gjithë nxënësve dhe prindërve të nxënësve me diabet që kanë nevojë për kujdes të lidhur me diabetin në shkollat e DOE-së. Kjo përmbledhje dhe marrëveshja nuk zbatohen për nxënësit që ndjekin shkolla charter, shkolla private ose programe parashkollore.

Si të kërkoj kujdes për diabetin për fëmijën tim ndërsa është në shkollë?

Dërgoni të 3 këto formularë si më poshtë:

Për infermieren/profesionistin mjekësor në ndërtesën e shkollës së fëmijës suaj:

- 1** Formulari për Administrimin e Barnave të Diabetit (Diabetes Medication Administration Form – DMAF), i plotësuar nga ofruesi i kujdesit shëndetësor të fëmijës suaj

Për Koordinatorin 504 të shkollës suaj:

- 2** Formulari i Kërkesës për Akomodime sipas Seksionit 504 nga prindi, së bashku me Autorizimin HIPAA (plotësohet nga prindi i nxënësit); dhe
- 3** Formulari i Kërkesës për Akomodime Mjekësore (Medical Accommodations Request Form), i plotësuar nga ofruesi i kujdesit shëndetësor të fëmijës suaj.

Të gjitha formularët mund të gjenden në faqet e internetit të Shërbimeve Shëndetësore të DOE (DOE Health Services) (<https://www.schools.nyc.gov/school-life/health-and-wellness/health-services>) dhe Akomodimeve 504 (<https://www.schools.nyc.gov/school-life/health-and-wellness/504-accommodations>).

Ju gjithashtu mund t'i kërkonit formularët nga Koordinatorin 504 i shkollës suaj.

Kush do të më ndihmojë?

- Drejtori i shkollës dhe Koordinatori i trajnuar 504 janë aty për t'ju ndihmuar. Emrat e tyre, adresat e emailit dhe numri i telefonit të shkollës gjenden në faqen Find a School (Gjej një Shkollë): <https://schoolsearch.schools.nyc/>.
- Infermierja e shkollës, Drejtori i Shëndetit i OSH (<https://auth-fohub.nyced.org/docs/default-source/default-document-library/health-director-contacts.pdf>) and
- Menaxheri i Programit 504 (212-287-0354, 504Questions@schools.nyc.gov), mund t'ju ndihmojnë gjithashtu.

Ku do të dokumentohet plani i kujdesit për diabetin i fëmijës suaj?

Plani i kujdesit për diabetin e fëmijës suaj do të përfshihet në **DMAF** dhe **Planin e tyre 504 për Diabetin**. Plani 504 për Diabetin krijohet nga Ekipi 504, që përfshin ju dhe stafin e shkollës që janë të njohur me nevojat e fëmijës suaj.

DMAF: Formulari DMAF është një formular urdhri për barna, që përshkruan nevojat mjekësore të lidhura me diabetin të fëmijës suaj, si p.sh. kur të trajtohet hipoglicemia dhe hiperglicemia, si të përcaktohet doza e insulinës, dhe kur të administrohet glukagoni. Formulari plotësohet nga ofruesi i kujdesit shëndetësor (p.sh. mjek, infermier praktikues ose asistent mjekësor), nënshkruhet nga ju dhe rishikohet nga OSH. Ofruesi i kujdesit shëndetësor të fëmijës suaj përcakton nëse fëmija është i varur nga infermierja (Nurse-Dependent), Nën mbikëqyrje (Supervised) nga një paraprofesionist ose staf i trajnuar i shkollës, ose, i pavarur (Independent) për matjen e glukozës në gjak dhe/ose administrimin e barnave (përveç glukagonit). Vetëm infermieri i shkollës, prindi ose personi i autorizuar nga prindi, dhe/ose nxënësi (nëse është i pavarur) kanë leje të administrojnë insulinë gjatë ndjekjes së shkollës ose pjesëmarrjes në programet dhe aktivitetet e DOE-së.

Plani 504 për Diabetin: Ekipet 504 duhet të përdorin modelin zyrtar të Planit 504 për Diabetin të DOE-së, i cili gjendet në <https://www.schools.nyc.gov/school-life/health-and-wellness/staying-healthy/diabetes>.

Plani do të plotësohet dhe miratohet në fund të mbledhjes së Ekipit 504, kur është e mundur, dhe do të rishikohet dhe rinovohet përpara përfundimit të çdo viti shkollor, ose më shpesh nëse është e nevojshme.

Plani 504 për Diabetin përshkruan shërbimet shëndetësore dhe akomodimet që fëmija juaj do të marrë për të ndjekur në mënyrë të sigurt shkollën dhe aktivitetet e programeve të DOE-së. Për shembull:

- Trajnimin e stafit të shkollës për kujdesin e lidhur me diabetin.
- Monitorimin e niveleve të glukozës në gjak dhe reagimin ndaj niveleve të ulëta ose të larta të glukozës (p.sh. nga një paraprofesionist ose anëtar tjetër i stafit të trajnuar në klasën e nxënësit).
- Ofrimin e kujdesit për diabetin nga stafi i trajnuar i shkollës gjatë ekskursioneve dhe aktiviteteve të tjera të sponsorizuara nga shkolla.
- Sigurimin që nxënësi të ketë qasje të menjëhershme në pajisjet e tij për diabetin dhe, kur nevojitet, në ujë, ushqim ose tualet.
- Përdorimin e insulinës nga infermierja e shkollës ose nga vetë nxënësi.
- Përdorimin e glukagonit në raste emergjente nga stafi i shkollës i trajnuar për ta bërë këtë ose nga infermierja e shkollës.
- Lejen për të kontaktuar prindin, siç përcaktohet në Planin 504 për Diabetin të fëmijës.

Nëse fëmija juaj që ka një DMAF (Formular për Administrimin e Barnave të Diabetit) merr arsim të veçantë përmes një **Programi të Arsimit të Personalizuar (Individualized Education Program – IEP)**, ose është në proces vlerësimi për IEP, atëherë ai/ajo duhet të ketë gjithashtu një Plan të veçantë 504 për Diabetin, përveç IEP-së, për të dokumentuar akomodimet e lidhura me diabetin.

Ekipi 504: Ekipi 504 është një grup personash në shkollë që njohin fëmijën tuaj dhe janë të njohur me nevojat e tij/saj akademike dhe ato të lidhura me diabetin. Në rastet kur kërkoen shërbime shëndetësore, pjesë e ekipit duhet të jenë infermieri i shkollës ose një anëtar i OSH-së (p.sh., Drejtori i Infermierisë në Bashki (Borough), Mbikëqyrësi i Infermierisë, Anëtar i Ekipit të Diabetit, ose ofruesi i kujdesit shëndetësor) duhet të jetë anëtar i Ekipit 504. Ekipi përfshin gjithashtu ju, prindin. Ekipi do të takohet në atë që quhet mbledhje e Ekipit 504 dhe do të punojë së bashku për të vlerësuar dhe përcaktuar nevojat e fëmijës në shkollë, si dhe mbështetjen që shkolla duhet të sigurojë për të përmbushur ato nevoja.

Sa kohë do të duhet që fëmija im të fillojë të marrë kujdesin për diabetin në shkollë?

Takimet në Shkollë: Nëse fëmija juaj tashmë merr kujdes për diabetin, Koordinatori 504 do t'ju kontaktojë në pranverë për të zhvilluar një takim lidhur me kujdesin për diabetin për vitin e ardhshëm shkollor. Në këtë takim, kur është e mundur, do të përfundojë dhe miratohet Plani 504 për Diabetin për nevojat shëndetësore të fëmijës suaj, përpara përfundimit të vitit shkollor.

Nëse është hera e parë që fëmija juaj ka nevojë për kujdes të lidhur me diabetin, brenda jo më shumë se **5 ditëve shkollore** pasi të dorëzoni DMAF, shkolla do të takohet me ju për të diskutuar mënyrën se si do të përmbushen nevojat e fëmijës suaj për kujdes ndaj diabetit derisa të miratohet Plani 504 për Diabetin, në mënyrë që fëmija të mund të ndjekë menjëherë shkollën. Këto nevoja mund të përfshijnë:

- identifikimin dhe trajnimin e stafit për hipogliceminë dhe hipergliceminë, dhe sigurimin që infermieri të jetë në gjendje të kryejë matjen e glukozës në gjak dhe administrimin e insulinës; dhe
- akomodime të tilla si akses në ushqim, ujë dhe tualet gjatë ditës shkollore.



Koordinatori 504 do t'ju kontaktojë me shkrim **brenda 5 ditëve shkollore** nga kërkesa juaj për akomodime për të planifikuar mbledhjen e Ekipit 504, e cila zakonisht do të mbahet brenda **15 ditëve shkollore** nga momenti kur DOE merr formularët tuaj të plotësuar të kërkesës 504. Ju dhe anëtarët e tjerë të Ekipit 504 që e njohin fëmijën tuaj (p.sh. mësuesi i fëmijës, infermieri i

shkollës ose infermieri i OSH-së) do të zhvillojnë së bashku Planin 504 për Diabetin në këtë takim.

Shërbimet e infermierisë: Nëse DMAF i dorëzuar për fëmijën tuaj është i qartë dhe gati për zbatim, infermieri i stafit të shkollës mund të fillojë **menjëherë** të ofrojë shërbimet shëndetësore për diabetin. Nëse ka pyetje lidhur me DMAF, ose nëse shkolla ka një infermieri zëvendësues në vend të infermierit të rregullt, OSH do ta shqyrtojë DMAF-in dhe, në shumicën e rasteve, do ta kthejë atë te infermieri i shkollës jo më vonë se dita pasuese e shkollës. Për të kërkuar një përditësim mbi statusin pas dorëzimit të DMAF, kontaktoni linjën e OSH për DMAF në 718-786-4933.




Të gjitha infermieret marrin trajnim për diabetin, duke përfshirë trajnim të përshtatur për nevojat specifike të fëmijës suaj - për shembull, për monitorin e vazhdueshëm të glukozës (Continuous Glucose Monitor) ose pajisje të tjera që përdor fëmija.

Shërbimet e Paraprofesionistëve: Nëse Ekipi 504 përcakton se fëmija juaj ka nevojë për një paraprofesionist për kujdesin ndaj diabetit, ai/ajo do të caktohet menjëherë, dhe në shumicën e rasteve brenda **5 ditëve shkollore**, si dhe duhet të trajnohet brenda **10 ditëve shkollore** nga momenti i caktimit.



Stafi i Trajnuar i Shkollës: Anëtarët e stafit të shkollës së DOE-së që janë përgjegjës për fëmijën tuaj — si mësuesi i klasës, trajneri ose këshilltari i klubit të DOE-së — identifikohen për trajnim gjatë mbledhjes së Ekipit 504. Pasi të jenë identifikuar, ata përfundojnë: Trajnimin e Nivelit 1 mbi bazat e diabetit brenda **10 ditëve shkollore**; ose Trajnimin e Nivelit 1 + Glukagon ose Nivelit 2 për diabetin (që përfshin trajnimin praktik në prani) brenda **15 ditëve shkollore**.



A duhet fëmija im të shkojë gjithmonë në zyrën e infermierit për kujdesin ndaj diabetit?

Jo. Kujdesi që merr fëmija juaj duhet të mundësojë që ai/ajo të kalojë sa më shumë kohë me shokët e klasës, me synimin për të kufizuar mungesat nga mësimi dhe ndarjen nga fëmijët e tjerë.

Ekipi 504 vendos së bashku ku duhet të ofrohet kujdesi, në mënyrë që të plotësohen më mirë nevojat individuale të fëmijës suaj. Për shembull, vendimi për vendndodhjen ku fëmija juaj do të marrë insulinën përcaktohet rast pas rasti, dhe nuk ka ndonjë rregull që kërkon që kujdesi të bëhet në dhomën mjekësore për çdo nxënës.

Një nxënës nuk mund të lihet pa kujdes për shkak të mungesës së burimeve, si p.sh. në rastet kur infermjerja e shkollës nuk është e pranishme.

A ofrohet kujdesi për diabetin gjatë ekskursioneve dhe aktiviteteve pas shkolle të DOE-së?

Po. Plani 504 për Diabetin i fëmijës suaj përcakton kujdesin që ai/ajo do të marrë gjatë ekskursioneve të DOE-së dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare (si aktivitetet pas shkolle të DOE-së, sportet, klubet dhe programet zhvilluese). Për shembull, kujdesi mund të përfshijë një infermieri shëtitëse (trip nurse) për nxënësit që varen nga infermjerja (Nurse-Dependent students) ose staf të trajnuar të shkollës për nxënësit që janë nën mbikëqyrje (Supervised) ose të pavarur (Independent) për

të ofruar kujdes rutinë ose emergjent ndaj diabetit.

Stafi i shkollës nuk duhet të kërkojë ose të kërkojë me detyrim që ju të merrni pjesë në ekskursione. Ju, ose një i afërm apo mik i zgjedhur nga ju, **nuk jeni të detyruar**, por mund të zgjidhni të shkoni me fëmijën tuaj në ekskursione ose në ndonjë aktivitet tjetër shkollor. Nëse një infermieri ose anëtar i trajnuar i stafit nuk është i disponueshëm, dhe ju nuk jeni pjesëmarrës, drejtori duhet të shtyjë ekskursionin sa herë që është e mundur, ose si zgjidhje e fundit ta anulojë, derisa të sigurohet kujdesi i duhur.

Një infermieri do të jetë në dispozicion për të administruar insulinën, nëse është e nevojshme, brenda **10 ditëve shkollore** nga momenti kur Ekipi 504 identifikon programin ku nxënësi ka nevojë për administrimin e insulinës. Një paraprofesionist ose anëtar tjetër i stafit do të identifikohet brenda **5 ditëve shkollore** nga vendimi, kur është e mundur, dhe jo më vonë se **10 ditë shkollore** pas vendimit. Stafi i trajnuar duhet të përfshijë një person zëvendësues, në rast se personeli kryesor i trajnuar nuk është i disponueshëm.

Nëse fëmija juaj po merr pjesë në një program pas-shkollor që nuk është pjesë e DOE-së, ju mund të kontaktoni Koordinatorin 504 për çdo shqetësim lidhur me aftësinë e programit për të akomoduar diabetin e fëmijës suaj,

në përputhje me detyrimet e tij të pavarura për mosdiskriminim.

A janë të disponueshme akomodimet për transportin?

Akomodimet për transportin rishikohen gjatë mbledhjes së Ekipit 504 kur plotësohet Plani 504 për Diabetin.

Kur transportohet një nxënës me DMAF, shoferi (për çdo lloj autobusi) dhe shoqëruesi (vetëm për autobusët e specializuar) marrin trajnimin e Nivelit 1 + Glukagon. Pas trajnimit, shkolla do t'i pajisë shoferin dhe shoqëruesin me një "udhëzues të veprimit të shpejtë", i cili përfshin identifikimin e simptomave të hipoglicemisë së lehtë deri në të moderuar, simptomave të zakonshme të hipoglicemisë së rëndë dhe hiperglicemisë, llojin e glukagonit të përshkruar për nxënësin, si dhe vendin ku mbahen glukagoni, ushqimet për diabetin dhe uji i siguruar nga prindi për nxënësin (p.sh. në xhepin e përparmë të çantës së shpinës) gjatë udhëtimit me autobus.

Për më shumë informacion, kontaktoni Koordinatorin 504 të shkollës suaj. Për më shumë detaje mbi përshtatshmërinë për transport, vizitoni <https://www.schools.nyc.gov/school-life/transportation>

